



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME PALËT

Nr. 318 prot.

Tiranë më 17.09. 2024

Lënda: Dërgohet raporti i monitorimit të buxhetit të DPS-së për 8-mujorin 2024.

MINISTRISË SË EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE RAPORTIMIT FINANCIAR
Tiranë

1. Hyrje, përshkrimi i institucionit

Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), si Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri, është përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e gjithë veprimtarisë kombëtare të standardizimit, me qëllim plotësimin e nevojave të palëve të interesuara për standarde teknike për të gjitha fushat e ekonomisë.

Misioni i punës së veprimtarisë së standardizimit është të sigurojë plotësimin e nevojave të të gjitha palëve të interesuara (industria/biznesi, tregtia, autoritetet publike, ambientalistët, konsumatorët, SME-të, akademia) për standarde teknike bashkëkohore në të gjitha fushat e ekonomisë, në mbështetje të konkurrueshmësisë dhe reduktimit të Barrierave Teknike në Tregti.

Qëllimi është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, kafshëve si dhe mjedisit.

Këto janë materializuar edhe ndërmjet qëllimit të programit 04160, i cili është: Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale

Për përmbushjen e sa më sipër, objektivat e DPS janë:

- Të përafrojë legjislacionin kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC).
- Të zbatojë dhe rishikojë të gjithë paketën ligjore për proceset e integritimit në fushën e standardizimit.
- Të organizojë dhe drejtojë punën për progresin në adaptimin e standardeve evropiane dhe informimin e ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë dhe palëve të interesuara për rëndësinë e standardeve
- Të mirëadministrojë Sistemin e Menaxhimit të Standardeve (SMS), shitjen e tyre dhe mirëfunksionimn e Autoritetit Kombëtar të Notifikimit dhe Pikës së Referimit në OBT dhe

CEFTA. Të funksionojnë sa më mirë strukturat e DPS (Bordi Drejtues, Bordi Teknik dhe Komitete Teknike)

Produktet sipas Programit : Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale me kod 04160, janë Standarde evropiane dhe ndërkombetare të adoptuara, miratuara si SSH si dhe Shitja e Standardeve.

2. Informacion buxhetor

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kreut VIII, nenit 65 "Monitorimi", Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", në zbatim të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qëndrore" për periudhën Janar – Prill 2024 janë planifikuar dhe shpenzuar fondet buxhetore të ndara në dy periudha.

Referuar shkresës së Minsitrisë së Financave Nr. 2917/1 Prot. datë 12.03.2024 "Kthim përgjigje" kodi i Drejtorise se Standardizimi ishte 1010281 deri ne 31 Mars 2024 dhe behët 101211 nga Prilli 2024.

Tabela 1. Akordimi i fondeve buxhetore për vitin 2024 dhe realizimi Janar- Gusht 2024.

Në 000 / lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN BUXHETI 2024	FAKT JANAR-MARS 2024 (kodi 1010281)	FAKT Gusht 2024 (kodi 1012111)	REALIZIMI 8-MUJORI 2024
1	Paga	20,000	4,871	9,226	14,097
2	Sigurime shoqërore	4,000	754	1,470	2,224
3	Mallra e shërbime të tjera	3,000	381	635	1,016
4	Transferta Korente të Huaja	14,000	4,169	3,479	7,648
5	Trans per Buxh. Fam. & Individ	344	4	273	277
6	Investime	1,000			
	Totali	42,344	10,179	15,083	25,262

Fondi i planifikuar buxhetor për vitin 2024 për DPS është në shumën 42,344 mijë lekë (tabela 1). Referuar shkresës së Minsitrisë së Financave nr. 4211/2 Prot. datë 19.04.2024 "Miratim limiti" fondet në zërin Shpenzime personeli 6009999 dhe në zërin "shpenzime Operative 6029999 kaluan nga kodi i vjeter 1010281 tek kodi 1012111,

- Struktura aktuale e DPS e miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 142 datë 26.09.2023 "Për një ndryshim në urdhrin nr. 182 datë 26.12.2018 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit", është me 15 punonjës. DPS gjate 4-mujorit të 2-te 2024 plotesoi dhe 2 pozicione vakant të nivelit - Specialist IV-2 duke plotesuar te gjitha vakancat në institucion.

3. Performanca me bazë gjinore, në nivel produkti

DPS në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtarë aktivizohet për të rritur vendimmarrjen e grave kryesisht në fushën e standardeve, por nuk bën trajtime me bazë gjinore ndaj dhe nuk mund të bëjë analizë të treguesve gjinorë.

4. Performanca e Buxhetit

Për 8-mujorin e vitit 2024, DPS ka realizuar fondet buxhetore në vlerën **25,262,000** nga **42,344,000** lekë buxheti i vitit 2024, ose 59,7 % % të buxhetit vjetor.

Të ardhurat nga shitja e standardeve

Për 8- mujorin e vitit 2024 numri i standardeve të shitura është **570** nga **360** të planifikuara për periudhën 8 -mujore, shoqëruar me realizimin e të ardhurave **1,039,214** lekë.

Standardet më të shitura i përkasin fushave:

Për 4-mujorin I-rë;

- Fruta, perime dhe nënprodukte të tyre;
- Analizat e produkteve ushqimore - Materialet në kontakt me ushqimin;
- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;
- Siguria e makinerisë dhe siguria ndaj zjarrit;
- Beton dhe produkte që lidhen me të. Automatizimi, menaxhimi dhe aksesorët në ndërtim.

Për 4-mujorin II-të;

- Produkte nafte, lubrifikantë, qymyre dhe produkte që lidhen me to;
- Bioteknologji dhe mikrobiologji;
- Qumësht, mish dhe produktet e tyre Siguria e makinerisë dhe siguria ndaj zjarrit;
- Dokumentacioni dhe informacioni.
- Pajisjet e përdorimit të gazit të lëngët nga nafta

4.1 Performanca jo-financiare

- **Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH)**

Gjatë 8 mujorit të vitit 2024 Janar - Gusht janë adoptuar në total **1537** standarde dhe dokumente standardizimi si Standarde Shqiptare (SSH) dhe Dokumente Standardizimi Shqiptare (DS) me procedurë të përshpejtuar me kërkesa nga palë të interesuara (biznese, institucione, laboratorë,

persona fizikë) dhe sipas programit të punës nga ku **755** standarde janë në fushën e Elektroteknikës dhe Telekomunikacionit - Sektori CENELEC/IEC dhe **782** standarde nga të gjitha fushat e ekonomisë - Sektori CEN/ISO.

Për periudhën **Janar - Gusht 2024** janë adoptuar **1537** standarde dhe dokumente standardizimi si Standarde Shqiptare (SSH) dhe Dokumente Standardizimi Shqiptare (DS); të cilat të ndara sipas origjinës së tyre janë si më poshtë:

- **600 standarde me origjinë evropiane CEN;**
 - **281 standarde me origjinë evropiane CLC;**
 - **182 standarde me origjinë ndërkombëtare ISO,**
 - **99 standarde me origjinë ndërkombëtare IEC,**
 - **375 standarde me origjinë evropiane ETSI.**
- Pjesa më e madhe janë standarde me origjinë evropiane, rreth **1,256** standarde (CEN, CLC dhe ETSI) dhe **281** standarde ndërkombëtare (ISO dhe IEC);

Standardet	Realizimi 8 mujori (Janar - Gusht 2024)	
CEN/ CENELEC	881	600 CEN
		281 CLC
ISO	182	
IEC	99	
ETSI	375	

● Disa nga fushat ku Komitetet Teknike kanë pasur numër më të madh adoptimesh në këtë periudhë (Janar- Gusht 2024) janë si më poshtë:

- Teknologjia e komunikimit dhe informacionit,
- Analizat e Produkteve Ushqimore,
- Pajisje Mbrojtëse personale,
- Pajisje Mjekësore,
- Siguria e Lodrave,
- Ndërtimit,
- Tekstilet,
- Pajisjet Elektrike dhe Elektronike,
- Siguria teknike dhe Mjedisi,
- Sistemet e informacionit;
- Trupa dhe lëndë druri e sharruar.

Në total janë adoptuar **33,317** standarde Evropiane duke përfshirë Amendamentet dhe Dokumentet e Standardizimit (CEN, CENELEC dhe ETSI) si Standarde Shqiptare (SSH), nga të cilat **5,868** standarde ETSI, **8,644** CENELEC dhe **18,805** CEN; dhe **7,365** janë standarde Ndërkombëtare (ISO dhe IEC).

Origjina	SSH	SSH EN	SSH ISO+IEC	Totali
Standardet	1965	33,317	7,365	42,647

Përbërja e arkivës së Standardeve Shqiptare SSH sipas origjinës, si më poshtë:

- 18,805 CEN;
- 8, 644 CENELEC;
- 5, 868 ETSI;
- 7, 365 (ISO+IEC);
- 1965 Standarde me origjinë puro shqiptare.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.



RIZA HASANAJ

Konceptoi: Alma Kolonjari, P/Sektor 

Konceptoi: Gentian Trebeshina, P/Sektor 

Pranoi: Kostanca Dedja, Drejtor 

Pranoi: Gentian Gjyrezi, Drejtor 